



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-121

Prishtinë, më 22 korrik 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 KORRIK 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Glauk Konjufca dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga: Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga: OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 korrik 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 15 korrik 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 korrik 2013.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy seanca dhe atë:

A) Vazhdimi i seancës plenare më 25 korrik 2013, në orën 10:00, me këtë

Rend dite

1. Debat parlamentar lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, roli i EULEX-it, Qeverisë së Kosovës dhe periudha e tranzicionit, sipas kërkesës së deputetit Kurtan Kajtazi, mbështetur nga deputetët nënshkrues.

B) Seanca e rregullt plenare më 25 korrik 2013, në orën 12:00, me këtë

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale,*

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 04/L-206 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregun dhe produktet e naftës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2012,
12. Shqyrtimi i raportit të Qeverisë së Kosovës për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës për vitin 2012,
13. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas,
14. Zgjedhja e një anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

1. *Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e pagës së drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës

1. Niveli i pagës së drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës caktohet në shumën prej 1 200 euro bruto në muaj.
2. Niveli i pagës drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, sipas pikës një (1) të këtij vendimi të zbatohet nga data 12 korrik 2013 deri në miratimin e Ligjit për pagat e funksionarëve publikë.

2. Kërkesa e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me procedimin e Raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 04-P-164, datë 27.05.2013, ta shqyrtojë raportin e Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Kërkesa e GP të AAK-së për emërimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e GP të AAK-së

Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, duke u mbështetur në nenit 67.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të ndryshimit të raportit të forcave politike në Kuvend, e arsyetoi kërkesën e këtij grupi për emërimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radha e deputetëve të GP të AAK-së, si dhe riradhitjen e ulëseve të deputetëve në sallën e seancave plenare, radhën e fjalës dhe radhitjen në dokumente zyrtare, sipas forcës politike aktuale në Kuvend.

Në lidhje me kërkesën e GP të AAK-së diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Glauk Konjufca, si dhe kryetarët e grupeve parlamentare, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Visar Ymeri dhe Ardian Gjini, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia nuk e mbështeti kërkesën e GP të AAK-së për emërimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radha e deputetëve të këtij grupi parlamentar.

4. Kërkesa e deputetes Alma Lama lidhur me procedimin e Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga komisionet e përhershme që pa vonesë t'i procedojnë raportet me rekomandime lidhur për këtë projektligj, që do të radhitet në rend dite të seancës së radhës për shqyrtim.

5. Njoftimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Maqedoni

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së të realizuar në Maqedoni prej 24-26 qershor 2013.

Të ndryshme:

Nënkryetari i Kuvendit, **Xhavit Haliti**, e shfaqti shqetësimin lidhur me shkrimet në disa media, në të cilat disa deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kualifikohen si vrasës, e nuk ka asnjë reagim zyrtar ndaj këtyre vlerësimeve të pabaza.

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, **Visar Ymeri**, propozoi që Kuvendi ta mbajë një seancë një jashtëzakonshme për të debatuar lidhur me migrimin ilegal të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Kryetari konstatoi se parashtrimi i kërkesës për seancë të jashtëzakonshme duhet ta marrë edhe pëlqimin e grupeve të tjera parlamentare.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale